



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 3.9.2019

Dokument parlamentar

R A P O R T

**PËR DEKRETIN NR. 11254, DATË 08.08.2019 PER KTHIMIN PËR RISHQYRTIM
Në KUVEND TË LIGJIT NR. 51/2019 "PER MIRATIMIN E KONTRATES SE
KONCESIONIT/PPP NDERMJET MINISTRISE SE INFRASTRUKTURES DHE
ENERGJISE, SI AUTORITETI KONTRAKTOR, DHE "GJIKURIA", SH.P.K., SI
KONCESIONARI, DHE SHOQERISE KONCESIONARE "RRUGA ORIKUM-
LLOGARA", SH.P.K., PER PROJEKTIMIN, NDERTIMIN DHE MIREMBAJTJEN
E RRUGES "PORTI I JAHTEVE -BY-PASS ORIKUM - DUKAT (URA E SHEN
ELIZES)"**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 3 shtator 2019, shqyrtoi dekretin e Presidentit të Republikës nr.11254, datë 8.8.2019 "Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 51/2019 "Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, dhe "Gjiguria", sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë koncesionare "Rruga Orikum-Llogara", sh.p.k., për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës "Porti i Jahteve -By-Pass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)".

Komisioni caktoi relator, për shqyrtimin e dekretit, deputeten Blerina Gjylameti.

Komisioni e shqyrton këtë dekret në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur dekretin dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, përfaqësues të institucionit të Presidentit të Republikës, Ministri i Financave, Zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përfaqësues të tjerë të këtyre ministrive.

- ***Arsyet e kthimit të ligjit sipas Presidentit të Republikës.***

Në materialin shpjegues të dekretit pasqyrohen arsyet e kthimit për rishqyrtim të ligjit, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

- Nuk evidentohet ndonjë akt i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për miratimin financiar të këtij projekti;
- Ka paqartësi, mungesë transparence dhe bazueshmërie ligjore në vlerësimin e projektit të koncesionit/PPP. Mungon një studim fizibiliteti i plotë dhe objektiv. Vlera e kontratës është e lartë.
- Autoriteti kontraktor nuk ka kryer ndonjë studim mbi procedurën ekonomike më të favorshme për ndërtimin e kësaj rruge: dhënien me koncesion apo prokurimin publik.

Gjithashtu, Presidenti evidenton se institucionet financiare ndërkombëtare kanë kërkuar nga qeveria shqiptare eliminimin e menjëhershëm të ofertave të pakërkua, për shkak të kostos së lartë në ekonominë e vendit.

Mbështetur në këto argumente, në materialin shpjegues të dekretit arrihet në përfundimin që ligji nr.52/2019 dhe kontrata bashkëlidhur tij janë në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës, cenojnë interesin publik, shkelin parimin e konkurrencës së lirë e të barazisë përpara ligjit, cenojnë transparencën e procesit të dhënies me koncesion/PPP, si dhe rëndojnë buxhetin e shtetit.

Për këto arsye, Presidenti i Republikës kërkon rishqyrtimin e këtij ligji në përputhje me parimet kushtetuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, duke reflektuar edhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare që asistojnë dhe monitorojnë vendin tonë dhe duke shmangur kostot e panevojshme financiare për familjet shiptare.

- ***Diskutimi në Komision.***

Relatorja e projektligjit analizoi dekretin dhe argumentet përkatëse, duke paraqitur mendimin e saj për secilin argument dhe për dekretin në tërësi.

Deputetët e mazhorancës e kundërshtuan dekretin e Presidentit të Republikës dhe argumentet që jepen për kthimin për rishqyrtim të ligjit.

Lidhur me pretendimin se nuk ka ndonjë akt të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për miratimin financiar të këtij projekti, deputetët e mazhorancës mbështetën argumentimet e propozuesve të projektligjit, të paraqitura në Komision, sipas të cilave e gjithë procedura e dhënies me koncesion/PPP është kryer në bashkëpunim të ngushtë me këtë ministri. Ky bashkëpunim vërehet në disa faza:

- *Së pari*, studimi i fizibilitetit është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për të përputhur tavanet buxhetore me parashikimet e modelit financiar;
- *Së dyti*, në kryerjen e procedurave ka pasur edhe përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- *Së treti*, projektvendimi dhe projektligji, para se të dërgohej për miratim në Këshillin e Ministrave, u miratua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- *Së katërti*, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është pjesë e strukturës së Këshillit të Ministrave, i cili e ka miratuar projektvendimin për këtë kontratë dhe e ka paraqitur në Kuvend për miratim.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në komunikimet zyrtare, ka dhënë dakordësinë për sa i përket kostos së modelit financiar, si dhe përmbajtjes së të gjitha dispozitave të kontratës.

Lidhur me pretendimet për vlerësimin e projektit të koncesionit/PPP, deputetët e mazhorancës mbështetën argumentet e dhëna në relacionin e projektligjit, si dhe informacionin e paraqitur në mbledhje nga drejtuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Ministrisë së Financave. Këto ministri zotërojnë dokumentacionin e plotë të procedurës konkurruese, kanë ekspertizën e nevojshme teknike e profesionale për njohjen dhe shqyrtimin e tij, si dhe janë përgjegjëse për kryerjen e kësaj procedure në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor. Kostoja e projektit mbështetet në studimin e fizibilitetit, të dorëzuar në autoritetin kontraktor nga ofertuesi fitues. Çmimet e përdorura në kontratë janë në përputhje me çmimet e manualeve që përdor Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndërtimin e veprave publike. Në koston e këtij projekti kanë ndikuar edhe lloji i punimeve që do të kryhen dhe situata gjeologjike e zonës.

Specifike për këtë projekt janë kryerja e punimeve në terren malor, zgjerimi i rrugës duke gërryer malin, ekzistenca e zonave ku rrezikohen rrëshqitje të thella të tokës etj.

Lidhur me kundërshtitë në drejtim të përdorimit të procedurës së propozimit të pakërkuar, për arsye se ka kosto të mëdha për buxhetin e shtetit, gjë që është kërkuar edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare, deputetët e mazhorancës shprehën mendimin se kontrata e koncesionit për segmentin rrugor Porti i Jahteve -By-Pass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës) është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor. Aktualisht, procedura e propozimit të pakërkuar është pjesë e kuadrit ligjor. Kjo procedurë përdoret në shumë vende të botës. Në kushtet kur burimet e buxhetit të shtetit janë të kufizuara, kjo procedurë mundëson kryerjen e investimit dhe vënien e tij në dispozicion të qytetarëve brenda një periudhe të shkurtër, ndërkohë që pagesat nga buxheti i shtetit shtrihen për 13 vjet. Kjo procedurë do të reduktohet ndjeshëm pas datës 1 tetor 2019, kur do të hyjë në fuqi ndryshimi ligjor në fushën e koncesioneve dhe PPP, të miratuar kohët e fundit nga Kuvendi.

Si konkluzion, deputetët e mazhorancës u shprehën kundër dekretit të Presidentit të Republikës. Ata theksuan se kontrata e koncesionit për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor “Porti i Jahteve - *By-Pass* Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës) është një akt i rëndësishëm për vendin tonë. Zbatimi i kësaj kontrate do të sjellë rehabilitimin e infrastrukturës rrugore në zonën e Vlorës, zhvillimin e turizmit, lehtësimin e trafikut dhe reduktimin e incidenteve. Miratimi i kësaj kontrate është një hap mjaft pozitiv për zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar, ai do të mbështesë zhvillimin e sektorëve strategjikë, duke gjeneruar rritje të të ardhurave, punësimit dhe të mirëqenies së qytetarëve. Ky aks rrugor është një nga segmentet më të rëndësishme të konektivitetit si brenda vendit, ashtu edhe në Ballkanin Perëndimor. Kostoja e projektit është përlllogaritur me çmimet sipas manualeve për zona gjeologjike të ngjashme.

Deputetët e opozitës u shprehën dakord me dekretin e Presidentit të Republikës, duke vënë theksin në koston e lartë të projektit të koncesionit/PPP.

- *Përfundim.*

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisionit nuk e miratoi dekretin e Presidentit të Republikës me shumicë votash.

RELATORJA
Blerina GJYLAMETI

KRYETARI
Arben AHMETAJ